



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE OPSTINA VUCITRN

02 Nr. / Br. 1779/24

Nr. i fq. / Br. sf

Data: / Datum 05.12.2024

VUSHTRRI - VUCITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenin 21 paragrafi 5 të Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Komunës nr.1546/24 dt.20.09.2024, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa datë 04 dhjetor 2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE
NË ADMINISTRATËN E KOMUNËS

1. Themelohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare në Administratën e Komunës, në këtë përbërje:
 - 1.1 Floriana Leku-Sadiku, kryesuese e komisionit
 - 1.2 Arbenita Maloku-Muzaqi, anëtare
 - 1.3 Jakup Qajalla, anëtar
2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në institucionet publike të administratës së komunës, në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përkatësisht Rregullën e aprovuar nga Kryetari i Komunës për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Komunës nr.1546/24 dt.20.09.2024.
3. Komisioni obligohet që para se të fillojë me verifikimin fizik të inventarit, të bashkëpunojë me zyrtarin e pasurisë dhe zyrtarin e pranimit/logjistikës në nxjerrjen e informatave të përditësuara nga regjistri E/pasuria dhe regjistri alternativ i të dhënave (excel) për çka obligohen për harmonizim.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe paraqes raport për inventarizim para datës 31 dhjetor 2024 Kryetarit të Komunës.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet: Nr. 1676/24 datë 08.11.2024 dhe 02Nr.1694/24 datë 15.11.2024 për themelimin e komisionit për inventarizim.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Zyrtarit të pasurisë
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1832/24

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 30.12.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 43 pika 12 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenin 4 dhe 5 të Rregullores (KKV) Nr. 03/23 prot. nr. 49/23 datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJE TË MIRËNJOHJEVE

1. Me rastin e shpalljes “Punëtor i Dalluar i vitit 2024” në administratën e komunës, iu ndahen mirënjohje dhe shpërblime në vlerë prej 200.00 € (dyqind euro), për secilin zyrtar të shënuar si në vijim:

Sadik Xhema	Drejtoria për Administratë
Bajram Beqiri	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
Abit Abiti	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Hyda Dallku	Drejtoria për Prokurim Publik
Islam Latifi,	Drejtoria për Shërbime Publike
Enver Bajrami	Drejtoria për Arsim
Ragbete Krasniqi	Drejtoria për Ekonomi dhe Investime Kapitale
Isa Latifi	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Hadika Abdurrahmani	Zyra e Kryetarit të Komunës
Fisnik Kamberi	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
Ekrem Miftari	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
Ferdane Përvetica	Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
Rabije Zahiti	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Muhamet Demiri	Drejtoria për Inspektime

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të komunës në bashkëpunim me Drejtoreshën e Administratës.
3. Ndarjen e mirënjohjeve do ta bëjë Kryetari i Komunës në darkën e fundvitit me punëtorë të administratës që do të mbahet me datën 20.12.2024 në ora 20:00 në Hotel “Amazona” – Milloshevë.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-40, nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-111 për Arkivat, Rregullores (MPB) Nr. 05/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (MAP) Nr. 01/2015 për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së Tyre, Ligji nr. 04/L-184 për Administrimin e punës në zyrë, nenit 7 paragrafi 1 të Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr.01/2017 për Administrimin e Punës në Zyrë Evidencat Themelore dhe Detyrat e Punës së Arkivistit, nenit 44 te par. 1 të statutit të Komunës si dhe kërkesës së Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme datë 20.12.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SHENJAVE UNIKE TË KLASIFIKIMIT TË DOKUMENTEVE DHE AFATET E RUAJTJES SË TYRE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

1. Me këtë vendim përcaktohet Lista e Shenjave të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre për Komunën e Vushtrrisë, në bazë të dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.
2. Lista me Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatin e ruajtjes së tyre në Komunën e Vushtrrisë, fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 735 (shtatëqind e tridhjetë e pesë).
3. Lista për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre për Komunën e Vushtrrisë është pjesë e këtij vendimi e bashkëngjitur në shtojcë.
4. Vendimi për miratimin e Listës Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre në Komunën e Vushtrrisë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Agjencionit Shtetëror të Arkivave të Kosovës
- Drejtorisë për Administratë